REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr.18393 Prot Shkodër, më 30.11.2023

KONTRATË QIRAJE

E lidhur sot më datë _____._____.2023, ndërmjet palëve :

QIRADHËNËSI : Bashkia Shkodër, përfaqësuar nga **z. Benet BECI** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. G50125189U, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rruga "13 dhjetori", Shkodër, në vijim "Qiradhënësi ".

dhe

QIRAMARRËSI: Shoqëria "Voltalia Albanie",shpk" , shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 03.02.2021, me nr. NIPT M11403024T, me seli në adresën: Rr.Bajram Curri, Ndërtesa European Trade Center ("ETC"), Kati 14, Njësia Administrative Nr. 2, 1000, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Menaxheri për Shqipërinë, Dr. Constantin von Alvensleben, shtetas gjerman, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës nr. C807G0LW0, i autorizuar siç duhet për nënshkrimin e kësaj Kontrate nëpërmjet Prokurës së Posaçme, datë 01/10/2023 (në vijim "Qiramarrësi")

Pjesëmarrësit në këtë kontratë do të quhen individualisht "Pala" dhe bashkërisht "Palët".

Baza ligjore

- Ligji nr.7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.57/2020 "Për pyjet"
- VKM nr 559 datë 29.07.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar
- VKM nr. 433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive", i ndryshuar

- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
- VKB nr. 18 datë 20.07.2023 "Për dhënie me qira të , të sipërfaqes 0.320 ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë, për një periudhë 12 muaj për shoqërinë "Voltalia Albanie" shpk.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër me Nr. 496/1 Prot., datë 02.08.2023 "Mbi Vendimin nr. 18 datë 20.07.2023".

Për sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1
Objekti i Kontratës

1.1 Objekti i Kontratës është dhënia me qira e tokës pyjore me sipërfaqe 0.320 ha , në e ndodhur në EP " Pruemos Sheldi" ngastra 104 NJA Guri i Zi , fshati Sheldi, sipas hartës treguese me koordinatat kufizuese që i bashkëngjitet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj, si dhe servitutit të kalimit "Rrugës" për të aksesuar sipërfaqen e dhënë me qira" ndodhur në EP " Pruemos Sheldi" ngastra 104 sipas hartës treguese me koordinatat kufizuese që i bashkëngjitet kësaj kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 2
Afati i Kontratës

2.1 Kjo Kontratë lidhet për një periudhë 12 mujore (1) vjeçare.
2.2 Kjo Kontratë hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

Neni 3

Vlera e qirasë

3.1 Qiramarrësi do ti paguajë iradhënësit detyrimin për qiranë vjetore të tokës dhe rrugës të marrë me qira në vlerën prej 93 898.4 (nëntëdhjetë e tre mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tetë presje katër) lekë në vit, e ndarë sipas zërave si më poshtë:

- Siperfaqia prej 0.320 ha x 184 000 lekë/ha/vit = 58 898.4 Lekë vit
- Rruge Kalimi prej 1 km x 35 000 lekë/km/vit = 35 000 Lekë vit

kjo bazuar në VKM nr 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore" i ndryshuar.

3.2 Për çdo ndryshim të tarifave të përcaktuara në Vendimin e sipërcituar Palët i nënshtrohen ndryshimeve përkatëse në Kontratë.

Neni 4

Pagesa dhe regjimi i saj

4.1 Pagesa e qirasë do të bëhet sipas kushteve të kësaj Kontrate.

4.2 Pagesa do të bëhet brenda 10 (dhjetë) ditëve nga nënshkrimi i Kontratës nga Palët dhe lëshimi I faturës sic përcaktohet në pikën 4.4 më poshtë.

4.3 Vlera e qirasë është e pandryshueshme.

4.4 Vlera e qirasë do të jetë vlera e përcaktuar në faturën për arkëtim të lëshuar nga Qiradhenesi. Kjo vlerë do të depozitohet në lekë (ALL) në llogarinë e Qiradhënësit (Bashkia Shkodër).

4.5 Dëftesa e bankës do të shërbejë si provë e kryerjes së pagesës, një kopje e së cilës i vihet në dispozicion Qiradhënësit.

4.6 Qiramarrësi përballon edhe pagesat e taksës vjetore dhe detyrime të tjera fiskale në lidhje me tokën pyjore, objekt kontrate.

Neni 5

Qëllimi dhe përdorimi i tokës pyjore

5.1 Toka e dhënë me qira do të përdoret nga Qiramarrësi për realizimin e aktivitetit të përcaktuar në VKB nr. 18 datë 20.07.2023 "Për dhënie me qira të , të siperfaqes 0.320 ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatëse për studimin e erës, aerogjeneratorë. për një periudhë 12 muaj për shoqërinë " Voltalia Albanie",shpk", që i bashkëlidhet kësaj Kontrate dhe është pjesë përbërëse e saj.

5.2 Qiramarrësi duhet ta përdorë tokën në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të ruajë funksionet natyrore që përmbush toka.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit

6.1 Qiradhënësi merr përsipër dhe i krijon Qiramarrësit mundësinë që ta gëzojë dhe ta përdorë tokën qetësisht ndaj pretendimeve të pabazuara ligjërisht të ngritura nga të tretët.

6.2 Qiradhënësi nuk përgjigjet për pretendime të tjera që nuk kanë të bëjnë sipërfaqen e dhënë në përdorim, me objektin dhe qëllimin e kontratës.

6.3 Qiradhënësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të Kontratës kur Qiramarrësi nuk ka shlyer vlerën e qirasë sipas përcaktimeve të nenit 4 të kësaj Kontrate, dëmton ose nuk mirëmban e përmirëson sipërfaqen e marrë në përdorim, nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga Kontrata, ato të përcaktuara në planin e rehabilitimit dhe nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë në fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.
Qiradhënësi monitoron planin e rehabilitimit të mjedisit pyjor objekt përdorimi, dhe merr në dorëzim siperfaqen e dhenë me kontrate qiraje me përfundimin e saj dhe pas rehabilitimit.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e Qiramarrësit

7.1 Qiramarrësi ka ta drejtë që për të punësuarit e tij, agjentë, përfaqësuesit dhe çdo person tjetër që Qiramarrësi i konsideron të përshtatshëm:
- të ketë të drejtën të hyjë lirisht në pronën objekt të kësaj Kontrate;
- të kryejë çdo veprim të cilin mund ta konsiderojë të nevojshëm ose të dobishëm gjatë ushtrimit të aktivitetit të tij
- të transportojë mallra paisje dhe materiale të tjera brënda sipërfaqes të marrë me qira
- të bëjë punime të tjera në përputhje me kërkesat e planit te rehabilitimit të sipërfaqes objekt përdorimi për ushtrimin e aktivitetit të saj.

7.2 Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë me qira dhe të lidhë nënkontraktime me subjekte të tjerë apo t'ja kalojë kontratën e lidhur një subjekti tjetër.

7.3 Qiramarrësi, do të kryejë me shpenzimet e veta, çdo punim mirëmbajtjeje që do ti konsiderojë të nevojshme në sipërfaqen e marrë në përdorim dhe në Rrugën e Kalimit.

7.4 Qiramarrësi do të përdorë sipërfaqen e marrë në përdorim dhe Rrugën e Kalimit me qëllim për të ushtruar aktivitetin që përcaktohet në nenet 1 dhe 2 të kësaj Kontrate , mbasi është pajisur me të gjitha Lejet e nevojshme nga Qiradhënësi.

7.5 Qiramarrësi do të mbrojë dhe mirë administrojë sipërfaqen pyjore/kullosore në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet" dhe të Ligjit 9693, datë 19.03.2007 " Për fondin kullosor", të ndryshuar dhe aktet e tjera nënligjore.

7.6 Qiramarrësi do të lejojë dhe të shoqërojë punonjësit e Bashkisë e të ushtrojnë kontrolle për zbatueshmërinë e kërkesave të përcaktuara në Kontratë për sipërfaqen e fondit pyjor/ kullosor të dhënë në përdorim.

7.7 Qiramarrësi detyrohet të zbatojë çdo dispozitë ligjore që del e re ose ndryshim që u bëhet atyre ekzistuese për pyjet, kullotat dhe gjuetinë.

7.8 Për çdo shkelje të konstatuar në zbatim të pikave të mësipërme të Kontratës, zbatohen kërkesat e neneve 36, 37 dhe 38 të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020 "Për pyjet"

Neni 8

Forca madhore

8.1 Në rast se ndonjë nga Palët e kësaj Kontrate pengohet të përmbushë të gjitha ose një pjesë të detyrimeve të saj të parashikuara në këtë Kontratë si pasojë e Forcës Madhore, kjo Palë nuk do të jetë përgjegjëse për mospërmbushjen e detyrimeve të saj gjatë kohëzgjatjes së Forcës Madhore dhe për pasojat e shkaktuara dhe që rrjedhin nga Forca Madhore. Pezullimi i ekzekutimit të kësaj Kontrate si pasojë e Forcës Madhore do të kufizohet në periudhën e kohës gjatë së cilës do të vazhdojnë efektet e Forcës Madhore. Për qëllimet e këtij neni, "Forcë madhore" do të thotë një ngjarje ose një akt natyror ose shoqëror që ndodh në vend , të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palës/palëve dhe nuk ndodhin për faj të tij/tyre, dhe pala/palët nuk është/janë në gjendje t'i eliminojë ato, edhe pse kanë ushtruar siç duhet aftësitë, përpjekjet dhe kujdesin e tij/tyre.

Neni 9

Zgjidhja e Kontratës

9.1 Kjo Kontratë përfundon në momentin e përfundimit të afatit të saj të përcaktuar në Nenin 2.

9.2 Kontrata zgjidhet përpara mbarimit të saj, vetëm për shkak të ndryshimit dhe mosrespektimit të kushteve kontraktore, të moskryerjes së pagesës së qirasë në afatin e caktuar.

9.3 Nëse rezulton ndonjëri nga rastet e parashikuara në këtë nen që përbën shkak për zgjidhjen e Kontratës, pala e dëmtuar i dërgon një njoftim me shkrim palës tjetër, duke i evitenduar shkeljen e kushteve të kontratës dhe lënien e një **afati 30 ditor** për plotësimin apo përmbushjen e kushteve kontraktore dhe se në rast të kundërt, pra në rast mospërmbushje pas kalimit të këtij afati, kontrata konsiderohet e zgjidhur. Ky njoftim ka vlerën e kushtit zgjidhës të kontratës pa qenë e nevojshme që zgjidhja të shpallet nga gjykata apo organ tjetër.

Neni 10

Dispozita të fundit

10.1 Për çështjet që nuk trajtohen në kontratën e mësipërme në rast se do lindin mosmarreveshje midis palëve, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil që trajtojnë kontratën e qirasë.

10.2 Mosmarrëveshjet gjatë zbatimit të kësaj kontrate, zgjidhen me mirëkuptim të palëve, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata kompetente .

10.3 Pjesë e kontratës janë:

- Kërkesa e subjektit me gjeneralitetet përktëse dhe dokumentat ligjore shoqëruese
- VKB nr. 18 datë 20.07.2023 "Për dhënie me qira të , të siperfaqes 0.3201ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë. për një periudhë 12 muaj për shoqërinë " Voltalia Albanie",shpk
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër me nr. 496/1 prot date 02.08.2023 "Mbi vendimin me nr. 18 datë 20.07.2023
- Deklarata e Punimeve
- Nipti i subjektit
- hartën topografike me koordinatat e siperfaqes objekt përdorimi në formatin PDF 1:10000 ku janë evidentuar elementët kryesore, nga këto kopje një e merr Qiramarrësi.

10.4 Çdo korrigjim i kontratës, pas nënshkrimit të saj, e bën atë të pavlefshme.
10.5 Kjo kontratë qiraje u hartua në gjuhën shqipe, në 3 (tre) kopje origjinale, e cila pasi u lexua palëve, u pranua dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë, një kopje origjinale iu dorëzua Qiramarrësit.

QIRADHËNËSI

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Benet BECI

QIRAMARRËSI

VOLTALIA ALBANIE, SHPK

MENAXHERI PËR VENDIN

Constantin von Alvensleben

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 21741/1 Prot Shkodër, më 03.02.2025

AMENDAMENT

KONTRATË QIRAJE NR.18399 PROT, DT 30.11.2023

E lidhur sot më datë _____._____.2025, ndërmjet palëve :

QIRADHËNËSI : Bashkia Shkodër, përfaqësuar nga **z.Benet BECI** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr.G50125189U, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rruga "13 dhjetori", Shkodër, në vijim "Qiradhënësi ".

dhe

QIRAMARRËSI: Shoqëria "Voltalia Albanie",shpk" , shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 03.02.2021, me nr. NIPT M11403024T, me seli në adresën: Rr.Bajram Curri, Ndërtesa European Trade Center ("ETC"), Kati 14, Njësia Administrative Nr. 2, 1000, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Menaxheri për Shqipërinë, nga z. Julian Lopez Garrido, qytetar Spanjoll, lindur në JAEN, më datë 03/10/1980, mbajtës i Pasaportës me nr. PAL778273, i autorizuar rregullisht për nënshkrimin e kësaj Kontrate nëpërmjet Prokurës së Posaçme datë 17/06/2024,(në vijim "Qiramarrësi")

Pjesëmarrësit në këtë kontratë do të quhen individualisht "Pala" dhe bashkërisht "Palët".

Baza ligjore

- Ligji nr.7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.57/2020 "Për pyjet"

- VKM nr 559 datë 29.07.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar
- VKM nr. 433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive", i ndryshuar
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
- VKB nr.18 datë 20.07.2023 "Për dhënie me qira të, të sipërfaqes 0.320 ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë për një periudhë 12 muaj për shoqërinë " Voltalia Albanie",shpk.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër me nr.496/1 Prot datë 02.08.2023 "Mbi Vendimin nr. 18 datë 20.07.2023
- Kontratës qiraje themelore nr.18399 prot dt 30.11.2023.
- VKB nr. 70 datë 06.11.2024 "Për një ndryshim ne VKB nr 18 dt 20.07.2024 'Për dhënie me qira të , të sipërfaqes 0.320 ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë. për një periudhë 12 muaj për shoqërinë " Voltalia Albanie",shpk.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër me nr.768/1 Prot datë 12.11.2024 "Mbi Vendimin nr.70 datë 06.11.2024

Për sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 1

Objekti i Kontratës

Objekti i Kontratës është dhënia me qira e tokës pyjore me sipërfaqe 0.320 ha , e ndodhur në EP " Pruemos Sheldi" ngastra 104 NJA Guri i Zi , fshati Sheldi, sipas hartës treguese me koordinatat kufizuese që i bashkëngjitet kësaj kontrates bazë dhe është pjesë përbërëse e saj, si dhe servitutit të kalimit "Rrugës" për të aksesuar sipërfaqen e dhënë me qira" ndodhur në EP " Pruemos Sheldi" ngastra 104 sipas hartës treguese me koordinatat kufizuese që i bashkëngjitet kontratës bazë dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 2

Afati i Kontratës

ishte

2.1 Kjo Kontratë lidhet për një periudhë 12 mujore (1) vjeçare.

bëhet

2.1 Kjo Kontratë lidhet për një periudhë 24 mujore (2) vjeçare.

2.2 Ky Amendim Kontratë hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

Neni 3
Dispozita të fundit

3.1 Të gjitha nenet e tjera të Kontratës Qirase themelore me nr.18399 prot dt 30.11.2023 mbeten të pandryshuara.

3.2 Ky amendament hartohet në gjuhën Shqipe në 3 (tre) kopje të njejta, të cilat nënshkruhen me vullnet të plotë nga të dyja palët.

QIRADHËNËSI

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Benet BECI

QIRAMARRËSI

VOLTALIA ALBANIE, SHPK

PËRFAQËSUES I AUTORIZUAR

Julian Lopez Garrido

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 8817 Prot Shkodër, më 15.04.2026

AMENDAMENT

KONTRATË QIRAJE NR.18399 PROT, DT 30.11.2023

E lidhur sot më datë _____._____.2026 , ndërmjet palëve :

QIRADHËNËSI : Bashkia Shkodër, përfaqësuar nga **Z.Benet BECI** në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. G50125189U, madhorë me zotësi të plotë për të vepruar, me adresë Rruga "13 dhjetori", Shkodër, në vijim "Qiradhënësi ".

dhe

QIRAMARRËSI: Shoqëria "Voltalia Albanie",shpk", shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 03.02.2021, me nr. NIPT M11403024T, me seli në adresën: Rr.Bajram Curri, Ndërtesa European Trade Center ("ETC"), Kati 14, Njësia Administrative Nr. 2, 1000, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga Ms. Kelly Leanne CLUTTERBUCK administratore per Shqiperine, shtetase angleze, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i Pasaportës nr. 157489949, e autorizuar siç duhet për nënshkrimin e kësaj Kontrate (në vijim "Qiramarrësi")

Pjesëmarrësit në këtë kontratë do të quhen individualisht "Pala" dhe bashkërisht "Palët".

Baza ligjore

- Ligji nr.7850 datë 29.07.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2014 datë 31.07.2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Ligji nr.57/2020 "Për pyjet"i ndryshuar

- VKM nr 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjorë kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", i ndryshuar
- VKM nr. 433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive", i ndryshuar
- Udhëzimin e Ministrit të Mjedisit nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik".
- VKB nr.18 datë 20.07.2023 "Për dhënie me qira të, të sipërfaqes 0.320 ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë për një periudhë 12 muaj për shoqërinë " Voltalia Albanie",shpk .
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër me nr.496/1 Prot datë 02.08.2023 "Mbi Vendimin nr. 18 datë 20.07.2023
- Kontratë qiraje themelore nr.18399 prot dt 30.11.2023.
- VKB nr. 70 datë 06.11.2024 "Për një ndryshim ne VKB nr 18 dt 20.07.2024 'Për dhënie me qira të , të sipërfaqes 0.320 ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë. për një periudhë 12 muaj për shoqërinë " Voltalia Albanie",shpk.
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër me nr.768/1 Prot datë 12.11.2024 "Mbi VKB nr. 70 datë 06.11.2024.
- VKB nr 19 dt 27.02.2026 "Për një ndryshim ne VKB nr 18 dt 20.07.2024 'Për dhënie me qira të , të sipërfaqes 0.320 ha në ekonominë pyjore "Pruemos Sheldi", ngastra 104, Nj.A Guri Zi, fshati Sheldi, për aktivitetin instalim të shtyllës erëmatese për studimin e erës, aerogjeneratorë. për një periudhë 12 muaj për shoqërinë " Voltalia Albanie",shpk.te ndryshuar
- Shkresa e Prefektit të Qarkut Shkodër me nr.183/1 Prot datë 12.03.2026. "Mbi Vendimin nr 19 dt 27.02.2026.

Për sa më sipër, palët bien dakord si më poshtë:

Neni 2

Objekti i Kontratës

Objekti i Kontratës është dhënia me qira e tokës pyjore me sipërfaqe 0.320 ha , në e ndodhur në EP " Pruemos Sheldi" ngastra 104 NJA Guri i Zi , fshati Sheldi, sipas hartës treguese me koordinatat kufizuese që i bashkëngjitet kësaj kontrates bazë dhe është pjesë përbërëse e saj, si dhe servitutit të kalimit "Rrugës" për të aksesuar sipërfaqen e dhënë me qira" ndodhur në

EP " Pruemos Sheldi" ngastra 104 sipas hartës treguese me koordinatat kufizuese që i bashkëngjitet kontratës bazë dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 2
Afati i Kontratës

ishte

2.1 Kjo Kontratë lidhet për një periudhë 24 mujore (2) vjeçare.

bëhet

2.1 Kjo Kontratë lidhet për një periudhë 36 mujore (3) vjeçare.

2.2 Ky Amendim Kontratë hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga të dyja Palët.

Neni 3
Dispozita të fundit

3.1 Të gjitha nenet e tjera të Kontratës Qirase themelore me nr.18399 prot dt 30.11.2023 mbeten të pandryshuara.

3.2 Ky amendament hartohet në gjuhën Shqipe në 3 (tre) kopje të njejta, të cilat nënshkruhen me vullnet të plotë nga të dyja palët.

QIRADHËNËSI

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Benet BECI

QIRAMARRËSI

VOLTALIA ALBANIE, SHPK

ADMINISTRATORI/PËRFAQËSUESI

Kelly Leanne CLUTTERBUCK

Kelly Clutterbuck

NUIS: M11403024T
VOLTALIA ALBANIE
SHPK
ALBANIA